



**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Fakulteti i Edukimit**

Programi i studimit:
Programi parashkollor

Niveli i studimeve:
Bachelor

Numri i kredive:
240 ECTS

Akredituar për periudhën:
1 Tetor 2016 - 30 Shtator 2019

Hartimi i këtyre materialeve është bërë me ndihmën e projektit "Modernizimi i Shkollimit të Mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës, nr. 544023" financuar nga Bashkimi Europian.

The European Commission support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents which reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.

PËRMBAJTJA:

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	4
2. REZULTATET E PRITURA:	5
3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Parashkollor	6
4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS:	9

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi themelor i programit parashkollor është të përgatisë kuadro të edukatoreve të ardhshme, të cilat do të jenë kompetente në punën profesionale me fëmijët e moshës parashkollore.

Ky program synon që edukatoret e ardhshme të zotërojnë pjesë teorike të fushës profesionale, të zbatojnë teorinë në praktika të përditshme, të mendojnë në mënyrë kritike dhe kreative si dhe të zhvillojnë shkathtësi praktike për të ndihmuar fëmijët në zhvillimin e tyre fizik, social, emocional dhe njohës.

Kompetencat e edukatoreve të ardhshme synohen të arrihen përmes programit katër vjeçar të këtij drejtimi, ku përfshihen aspektet teorike pedagogjike dhe psikologjike, pedagogji të fushave multidisiplinare dhe akademike si dhe praktika pedagogjike, e cila organizohet nëpër institucione parashkollore dhe shkolla, në kuadër të të cilave ndodhen edhe klasat parafillore.

Gjatë periudhës katër vjeçare studentët do të përfshihen edhe në aktivitete të ndryshme jashtë kurrikulare si dhe hulumtime të ndryshme, të cilat do t'i ndihmojnë ata që të identifikojnë dhe zgjidhin çështje, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë me punën e tyre me fëmijë të moshës parashkollore.

Metodologjia e punës është ndër komponentët më të rëndësishme të këtij programi. Studentët do të kenë mundësi të përvetësojnë metodologji nga trendet bashkëkohore, përfshirë edhe vlerësimin e të arriturave të fëmijëve, përmes së cilave do t'i ndihmojnë zhvillimit të fëmijëve për të qenë të përgatitur për procesin e mëtutjeshëm të shkollimit të tyre si dhe për të qenë qytetarë të përgjegjshëm dhe aktivë në shoqërinë tonë.

2. **REZULTATET E PRITURA:**

- Ndërtojnë njohuri mbi bazat e edukimit parashkollor, zhvillimin e fëmijëve si dhe krijimin e ambientit të përshtatshëm edukativ për fëmijët e kësaj moshe;
- Njohin sistemin e politikave arsimore dhe dokumentacionin që do të punojnë në punën e tyre të përditshme;
- Zbërthejnë kurrikulën në aktivitetet e planifikuara për fëmijë, duke e orientuar punën e tyre sipas qasjes me fëmijën në qendër;
- Organizojnë aktivitete edukative, duke synuar arritjen e rezultateve të të nxënit, të parapara me Kornizën kurrikulare të Kosovës, sipas fushave përkatëse;
- Aplikojnë metodologji bashkëkohore gjatë punës me fëmijë, duke u mundësuar atyre zhvillim fizik, gjuhësor, zhvillim mbi konceptet bazë matematikore, artistike, duke u mundësuar fëmijëve të shkathtësohen për mirëqenie, jetë dhe punë;
- Zbatojnë forma të ndryshme të vëzhgimit të fëmijës, përmes së cilës arrijnë të identifikojnë nevojat dhe interesat e tyre individuale;
- Zbatojnë qasje gjithëpërfshirëse në procesin e realizimit të planit dhe programit, duke u dhënë mundësi të barabarta secilit prej tyre;
- Shkathtësohen në organizimin e përgatitjes së tyre profesionale, duke punuar në ekipe;
- Zbatojnë qasje të ndryshme për partneritet me familjen dhe komunitetin;
- Reflektojnë në zhvillimin e vazhdueshëm të tyre profesionale, duke kontribuar në ngritjen dhe avancimin e cilësisë në punë me fëmijët e moshës parashkollore;

3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Parashkollor

VITI I PARË SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Teoria e edukimit	O	3+2	6
2.	Hyrje në psikologji	O	2+2	6
3.	Hyrje në pedagogjinë parashkollore	O	2+2	6
4.	Gjuhë shqipe I	O	3+2	6
5.	Artet figurative me metodologji	O	3+2	6
Gjithsej			13+10	30

SEMESTRI II

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Gjuhë shqipe II	O	3+2	6
2.	Edukimi fizik dhe shëndetësor	O	2+2	5
3.	Edukimi parashkollor me praktikë I	O	3+2	6
4.	Edukimi muzikor	O	2+2	5
5.	Familja dhe edukimi parashkollor	Z	2+1	4
6.	Shkathësi të gatishmërisë për jetë dhe punë	Z	2+1	4
7.	Zhvillimi psiko-motorik	Z	2+1	4
8.	Të nxënit përmes lojës	Z	2+1	4
Gjithsej			14+10	30

VITI I DYTË SEMESTRI III

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Psikologji zhvillimore	O	3+1	6
2.	Konceptet matematikore në fëmijërinë e hershme	O	3+2	6
3.	Interpretimi në instrumentet muzikore	O	2+2	5
4.	Metodologji e shkencave shoqërore	O	2+2	5
5.	Shkathësi lëvizore	Z	2+1	4
6.	Edukimi moral në fëmijërinë e hershme	Z	2+1	4
7.	Shkathësitë e komunikimit dhe zgjedhja e konflikteve	Z	2+1	4
8.	Artet e bukura	Z	2+1	4
9.	Partneriteti i IP me komunitetin	Z	2+1	4
Gjithsej			14+9	30

SEMESTRI IV

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Gjithpërfshirja në edukimin parashkollor	O	3+2	6
2.	TIK në edukimin parashkollor	O	3+2	6
3.	Konceptet gjeometrike në fëmijërinë e hershme	O	3+2	6
4.	Praktikë pedagogjike II (5 javë)	O	2+1	4
5.	Zhvillimi socio-emocional	Z	2+1	4
6.	Kulturë e të folurit	Z	2+1	4
7.	Këndimi koral-KORI	Z	2+1	4
8.	Eksperimenti në fëmijërinë e hershme	Z	2+1	4
9.	Organizimi dhe menaxhimi në kontekst të edukimit	Z	2+1	4
Gjithsej			15+9	30

**VITI I TRETË
SEMESTRI V**

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Zhvillimi motorik me metodologji	O	3+2	6
2.	Vështirësitë në të nxënë	O	2+2	5
3.	Komunikimi në arsim	O	2+2	5
4.	Gjuhë angleze I	O	3+1	6
5.	Biologjia për edukatorë	Z	2+1	4
6.	Lojërat ritmike dhe vallëzimi	Z	2+1	4
7.	Psikologji kognitive	Z	2+1	4
8.	Strategjitë e edukimit parashkollor	Z	2+1	4
9.	Lojërat matematikore	Z	2+1	4
Gjithsej			14+9	30

SEMESTRI VI

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Psikologji e edukimit	O	2+2	5
2.	Letërsi për fëmijë	O	3+2	6
3.	Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla	O	3+2	6
4.	Praktikë pedagogjike III (6 javë)	O	2+0	5
5.	Politikat arsimore dhe dokumentacioni pedagogjik	Z	2+1	4
6.	Gjuhë angleze II	Z	2+1	4
7.	Zhvillimi profesional i mësimeve të mësuara	Z	2+1	4
8.	Çrregullimet në sjellje	Z	2+1	4
9.	Etika profesionale	Z	2+1	4
Gjithsej			14+8	30

**VITI I KATËRT
SEMESTRI VII**

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Vlerësimi në edukimin e hershëm	O	2+2	5
2.	Metodologji e shkencave natyrore	O	3+2	6
3.	Punë dore me modelim	O	3+2	6
4.	Edukimi mjedisor	O	2+1	5
5.	Puna me projekte edukative	Z	2+1	4
6.	Shkathësitë e gatishmërisë për shkollë	Z	2+1	4
7.	Puna me fëmijët e talentuar	Z	2+1	4
8.	Metodologji e leximit letrar	Z	2+1	4
Gjithsej			14+9	30

SEMESTRI VIII

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Metodologji e hulumtimit në edukim parashkollor	O	3+2	6
2.	Praktikë pedagogjike IV (8 javë)	O		14
3.	Provim Përfundimtar	O		10
Gjithsej			3+2	30

4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS:

Përshkrimi për secilin kurs	
1	<p>Teori e edukimit</p> <p>Kursi do trajtojë çështje si: kuptimi i disa koncepteve themelore të T.E., zhvillimi i teorisë së kurrikulumit mësimor, strategjitë aktuale mësimore (nëntë strategjitë), planifikimi vjetor, tematik dhe konspekti i orës mësimore, struktura e procesit mësimor, detyrat – qëllimet/ kognitive, afektive dhe psiko-motorike, faktorët e mësimimit, sistemet mësimore, format e punës mësimore, përmbajtja mësimore, plani dhe programi mësimor zyrtar, rrjedha e procesit mësimor, rëndësia e njohjes së inteligjencave të shumëfishta për mësim me nxënësin në qendër.</p>
2	<p>Hyrje në psikologji</p> <p>Kursi do të njohë studentët me konceptet bazë që e përkufizojnë psikologjinë, me fushën e studimit, teoritë themelore, me metodologjinë e saj si dhe zbatimin e psikologjisë në praktikë. Në përgjithësi kursi përfshinë bazat e psikologjisë së përgjithshme, njohuritë e proceseve bazike në psikologji, si dhe të atyre superiore. Përmes këtij kursi pretendohet të qartësohen proceset e ndryshme mendore dhe sjellja e njeriut sipas gjurmimeve shkencore apo empirike. Ndërlidhja e informatave të ndryshme që trajtohen, do të jetë tema kryesore e njohurive të përfituara e të arritura nga studentet. Studentët do të njihen me bazat e krijimit të psikologjisë si shkencë moderne. Ata do të mësojnë për proceset intelektuale, kognitive dhe emocionale dhe metodat e mjetet e hulumtimit të këtyre proceseve</p>
3	<p>Hyrje në pedagogjinë parashkollore</p> <p>Gjatë kursit do të shqyrtohet aspekti teorik dhe praktik i edukimit të fëmijëve në moshën e fëmijërisë së hershme sipas teorive të ndryshme shkencore si dhe nevojave të fëmijës. Roli i domosdoshëm dhe sfidues i edukatorit kompetent, rrugët e ndryshme të edukimit përgjatë historisë, si dhe programet e ndryshme të edukimit, janë çështje të cilat duhen kuptuar nga studenti. Analiza e njohurive, shprehive dhe shkathësive, bindjeve, qëndrimeve e botëkuptimeve të edukatorit në harmoni me nevojat dhe qëllimet e edukimit si dhe në harmoni me standardet e edukimit parashkollor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, do sjellin edhe mundësinë e krijimit të filozofisë personale për edukimin në fëmijërinë e hershme.</p>
4	<p>Gjuhë shqipe I</p> <p>Kursi do trajtojë çështje si: gjuha si mjet komunikimi; gjuha si dukuri shoqërore e si sistem shenjash; shumësia e gjuhëve, familjet e nënfamiljet e gjuhëve; gjuha - populli – kombi – shteti (raportet, përkimet); piramida gjuhësore; gjuhësia; origjina dhe historia e gjuhës shqipe; fonetika; fonetika nyjetimore; fonetika akustike; klasifikimi i tingujve</p>

	<p>zanorë dhe bashkëtingëllore; fonologjia; ndryshimet fonemore – kombinatorike (të gjalla e historike); prosodia, rrokja, theksi, intonacioni; Tingulli, grafia, fonema; drejtshkrimi/drejtshqiptimi.</p>
5	<p>Artet figurative me metodologji</p> <p>Në këtë kurs do të shfrytëzohen njohuritë themelore si: bisedë përgatitore për formën dhe përmbajtjen. Lloje vizatimi: vizatim nga natyra; vizatim dekorativ, vizatim tematik. Njohuri mbi perspektivën, formën, drejtpeshimin, hapësirën, ritmin. Dekoracionet gjeometrike. Logotipet. Peizazh nga natyra. Skica, Portreti. Autoportreti. Kroki. Karikatura. Ilustrimi me akuarel. Vija, shkarravina dhe vizatimi. Vizatimi për parashkollorë dhe rëndësia e tij. Vizatimi simetrik me ndihmën e palosjes. Skica dhe pikturimi në akuarel. Vizatimi, llojet e materialeve dhe përdorimi i tyre. Punimet me tush, bajc, mjetet e duhura për përdorim. Vizatimi si formë e ndërgjegjes shoqërore. Vizatimi dhe pjesët përbërëse të tij. Simbolet e figurave, psikologjia e artit, motivimi i fëmijëve përmes shkarravinave. Vizitë në galeri artesh.</p>
6	<p>Gjuhë shqipe II</p> <p>Emri (gjinia, numri, rasa, trajta, rasat e shquarsisë, lakimet e emrit); mbiemri; numërori; përemri (kuptimi, klasifikimi i përemrave); përemri (përemri dëftor, përemri lidhor); përemri (përemri i pacaktuar, përemri pronor, përemri pyetës); folja (kategoritë, format veprorë e joveprorë, trajta vetvetore, mënyrat, format e pashtjelluara, kohët, vetat dhe numri, zgjedhimet, tipat e zgjedhimeve, zgjedhimi vepror); ndajfolja; parafjala; lidhëza; pjesëza; pasthirrma.</p>
7	<p>Edukimi fizik dhe shëndetësor</p> <p>Kursi ofron informacione në lidhje me zhvillimin fizik dhe lëvizor në fëmijërinë e hershme, që janë mjaft të rëndësishme dhe kanë lidhje të ngushtë me të gjitha fushat e tjera të zhvillimit. Kursi ofron për studentët njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e zhvillimit të shëndetit dhe atij motorik, informacione rreth procesit të zhvillimit motorik, mënyrës se si fëmijët i mësojnë lëvizjet, inteligjencës kinestetike si dhe ide e aktivitete, të cilat mbështesin zhvillimin optimal të fëmijëve në këtë fushë.</p>
8	<p>Edukimi parashkollor me praktikë I</p> <p>Në këtë kurs, studentët do të kenë mundësi të njihen me rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme. Kursi do të ofrojë informacione rreth qasjes pedagogjike, që edukatorët duhet të kenë gjatë punës së tyre me fëmijët parashkollorë. Do të trajtohen qasje të ndryshme të zhvillimit të fëmijëve, duke u përqendruar në standardet e zhvillimit dhe fushat e zhvillimit sipas kornizës kurrikulare. Do të trajtohen edhe qasjet bashkëkohore të punës me fëmijët e kësaj moshe, duke e ndihmuar atë të zhvillohet në aspektin e tërësishëm, që do ta arrijnë përmes aktiviteteve të ndryshme edukative dhe</p>

	<p>kreative-lojës. Ky kurs do t'u mundësojë studentëve të orientohen në plotësimin e kërkesave dhe predispozitave të fëmijës, duke i orientuar ata për punë të pavarur, zhvillim të menduarit kritik dhe kreativ. Theks i veçantë do t'i kushtohet edhe përcjelljes së zhvillimit të fëmijës, duke e mbajtur nën procesin e vëzhgimit dhe duke e dokumentuar zhvillimin e tyre përmes portofolios së fëmijëve. Studentët gjatë këtij kursi do të kenë mundësi që gjitha njohuritë teorike t'i praktikojnë gjatë praktikës pedagogjike në IP. Do të kenë mundësi të krijojnë portofolio profesionale, që do t'i ndihmojë në zhvillimin e vazhdueshëm e që do të ndikojë në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre profesional.</p>
9	<p>Edukimi muzikor</p> <p>Ky kurs përfshin disa metoda dhe strategji bazike të mësimdhënies së muzikës për kopshtet parashkollore. Fokusi qëndron në realizimin e komponenteve të edukimit muzikor që parashihen në programin mësimor (Kurrikulën e edukimit parashkollor dhe standardet e përgjithshme të edukimit parashkollor). Po ashtu përfshihen edhe disa aspekte teorike të mësimdhënies muzikore siç janë qëllimet, objektivat, rezultatet e pritura, etj.</p>
10	<p>Familja dhe edukimi parashkollor</p> <p>Kursi do të trajtojë një ndër komponentët më të rëndësishëm të zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve: rëndësinë e bashkëpunimit të edukatores me familjen. Studentët do të kenë mundësi të kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe qasjet e ndryshme, që edukatorja do të duhej t'i aplikonte për të përfshirë familjen në programet edukative të fëmijëve parashkollorë nëpër institucionet parashkollore.</p> <p>Përmbajtja e këtij kursi do t'ju ofrojë mundësi studentëve që të analizojnë qasje të ndryshme, të cilat i kanë trajtuar studiuesit më të shquar në fushën e edukimit parashkollor. Gjithashtu studentët do të kenë mundësinë që të zbatojnë forma të ndryshme të bashkëpunimit me familje, përmes aktiviteteve të parapara gjatë kësaj periudhe.</p>
11	<p>Shkathtësi të gatishmërisë për jetë dhe punë</p> <p>Kursi ofron informacione në lidhje me shkathtësitë bazike për jetë, të cilat duhet t'i fitojë secili fëmijë gjatë edukimit të tij në moshën parashkollore. Krijimi i vetëbesimit, krijimi i imazhit për veten, njohja dhe shprehja e emocioneve, ballafaqimi me suksesin dhe mosesuksin, shprehja e mendimit, pranimi i ngjashmërive dhe dallimeve, dhënia dhe pranimi i ndihmës, tregimi i të së vërtetës, pranimi i gabimeve, komunikimi, zgjidhja e konflikteve, përvetësimi i shprehive për aktivitet fizik dhe ushqim të shëndetshëm, kujdesi për higjienën personale, krijimi i raportit pozitiv me të tjerët dhe me ambientin, do të jenë përmbajtja kryesore e kësaj lënde. Kursi vë theksin edhe në përfshirjen dhe angazhimin e familjes në punën edukative, me qëllim krijimin e</p>

	kushteve optimale të zhvillimit të gatishmërisë për jetë të fëmijëve.
12	<p>Zhvillimi psiko-motorik</p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi të zhvillojnë njohuri mbi proceset dhe mekanizmat e zhvillimit të aftësive motorike: ndryshimet, proceset dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin motorik. Kursi ofron informacione në lidhje me zhvillimin fizik dhe lëvizor në moshën parashkollore, që janë mjaft të rëndësishme dhe ngushtësisht të lidhura me të gjitha fushat e tjera të zhvillimit. Kursi ofron për studentët njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e zhvillimit të shëndetit dhe atij motorik, informacione rreth procesit të zhvillimit motorik, mënyrës se si fëmijët i mësojnë lëvizjet, inteligjencës kinestetike si dhe ide e aktivitete, të cilat mbështesin zhvillimin optimal të fëmijëve në këtë fushë.</p>
13	<p>Të nxënit përmes lojës</p> <p>Ky kurs do të ofrojë njohuri për rëndësinë e të nxënit që fëmijët e arrijnë përmes lojës. Studentët do të kenë mundësi të kuptojnë teori të ndryshme për të nxënit përmes lojës, do të kenë mundësi të ushtrojnë shkathtësitë dhe kreativitetin e tyre, duke planifikuar dhe organizuar lojëra me karakter edukativ, të cilat do të bazohen në fushat zhvillimore të parapara me kurrikulën e vendit. Përmes këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të reflektojnë dhe analizojnë rolin e edukatores në përcaktimin, planifikimin dhe orientimin e fëmijëve gjatë procesit të lojës. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet edhe rolit të edukatores për të vëzhguar fëmijët gjatë procesit të lojës, përmes së cilës do të kenë mundësi të identifikojnë interesat dhe nevojat e fëmijëve në baza individuale.</p>
14	<p>Psikologji zhvillimore</p> <p>Në përgjithësi kursi tenton të qartësojë nocionet e zhvillimit të gjithëmbarsëm të fëmijës, dhe ndërveprimet e fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e tij. Kursi synon në aftësimin e studentëve për të kuptuar më mirë zhvillimin e fëmijës në aspektin fizik, motorik, mendor, emocional dhe social, mënyrat e tij të reagimit, si fëmija i shfaq emocionet, si zhvillohen ato, si socializohet fëmija, sa është e rëndësishme njohja e emocioneve dhe aspekteve sociale të zhvillimit të fëmijës, si mëson fëmija, si zhvillohet intelektualisht dhe si të kujdesemi për fëmijën që mos të krijojmë vështirësi emocionale dhe sociale në zhvillimin e tij.</p> <p>Do të bëhet aftësimi i studentëve që të kuptojnë më mirë zhvillimin e fëmijës në të gjitha aspektet, mënyrat e tij të reagimit, sa është e rëndësishme njohja e emocioneve dhe aspekteve sociale të zhvillimit të fëmijës, dhe si të kujdesemi për fëmijën që mos të krijojmë vështirësi emocionale dhe sociale në zhvillimin e tyre.</p>

15	<p>Konceptet matematikore në fëmijërinë e hershme</p> <p>Në kursin, konceptet matematikore në fëmijërinë e hershme, shqyrtohen konceptet themelore, si: logjika matematikore, bashkësitë, relacionet binare, lidhjet në matematikë, zhvillimi i konceptit numër dhe numërim, veprimet themelore në matematikë, elemente nga puna me të dhënat dhe shfrytëzimi i mjeteve të konkretizimit dhe atyre manipulative. Studentët do të analizojnë metodat më të përshtatshme të të nxënit të matematikës në nivelin parashkollor.</p>
16	<p>Interpretim në instrumente muzikore</p> <p>Kursi është i ndarë në disa pjesë: njohja me instrumentin, mundësitë teknike, pjesët e tij, mënyra e interpretimit, interpretimi i shkallëve (C,G, me dy duar dhe D ,A, E, H, FIS, CIS, F, B, ES, AS, DES, GES,CES, me nga një dorë, interpretimi i shkallëve (a, e, me dy duar, h, fis, cis, gis, dis, ais, d, me dy duar g, c, f, b, es, as, me nga një dorë, interpretimi i 8 këngëve me specifika të grupmoshës së të vegjëlve, përkatësisht të kl. së parë të shkollës fillore, interpretohen 5 lojëra muzikore përkatësisht 8 këngë të klasës së tretë të shkollës fillore, interpretimi në veglat e Orfit i këngëve të realizuara në instrument klasik, interpretimi i 4 modeleve.</p>
17	<p>Metodologji e shkencave shoqërore</p> <p>Kursi ofron vizionin e përgjithshëm të zhvillimit dhe formimit të ideve, koncepteve, kategorive shoqërore, në predimensionim të mirëqenies. Ofron të kuptuarit dhe interpretuarit e kategorisë së shoqërisë dhe të fenomenologjisë së saj. Shtron rrafshet e të kuptuarit të botës së shoqërisë, përmes shpjegimit të fenomeneve sociale, antropologjike, politike, ekonomike në strukturën sociale, në forcat sociale dhe në raportet shoqërore.</p>
18	<p>Shkathtësitë lëvizore</p> <p>Kursi ofron informacione në lidhje me zhvillimin e aftësive manipulative në fëmijërinë e hershme, mjaft të rëndësishme dhe ngushtësisht të lidhura me sportin dhe lojërat. Këto shkathtësi kërkojnë kryesisht aftësinë për të kontrolluar trupin, aftësitë e koordinimit në hapësirë dhe aftësitë për të kontrolluar objektet dhe rekuizitat, me të cilat manipulon. Kursi ofron për studentët njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive manipulative, informacione rreth procesit të zhvillimit motorik, mënyrës se si fëmijët i mësojnë lëvizjet, inteligjencës kinestetike si dhe ide e aktivitete, të cilat mbështesin zhvillimin adekuat të shkathtësive manipulative të fëmijëve të moshës parashkollore. Gjithashtu ata kuptojnë edhe nevojën e ofrimit të një ambienti motivues, me materiale dhe rekuizita të llojllojshme, të cilat promovojnë zhvillimin motorik dhe shkathtësitë manipulative.</p>
19	<p>Edukimi moral në fëmijërinë e hershme</p>

	<p>Kursi ofron informacione në lidhje me moralin dhe teoritë e tij, zhvillimin e bindjeve dhe qëndrimeve morale, formimin e shprehive të sjelljeve morale, edukimin e veçantive morale të vullnetit dhe të karakterit si dhe formimin e botëkuptimit mbi moralin dhe vlerat e tij. Edukatorët profesioniste do të jenë në gjendje, që përmes kësaj lënde, të zhvillojnë tek fëmijët parashkollorë respektimin e normave morale, siç janë kontrollimi i emocioneve, pritja në rend, ndarja e gjërave të përbashkëta, respektimi i njëri-tjetrit, respektimi i ambientit ku rriten dhe mësojnë, respektimi i materialeve (lodrave), krijimi i shprehive morale si kërkimfalja, mirësjellja, dashuria ndaj njëri-tjetri, ndaj vendit ku jetojmë etj.</p>
20	<p>Shkathtësitë e komunikimit dhe zgjidhja e konflikteve</p> <p>Kursi “Shkathtësitë e komunikimit me fëmijë dhe zgjidhja e konflikteve” synon që të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuri lidhur me konceptet dhe modelet kryesore të teorive të komunikimit, sistemet e komunikimit, funksionet, procesin, format, tipat e komunikimit njerëzor (verbal dhe jo verbal, intrapersonal, ndërpersonal, në grupe të vogla, në grupe të mëdha, komunikimi masiv, etj), duke vënë vazhdimisht theksin tek komunikimi me fëmijë dhe përvetësimi i shkathtësive të nevojshme në edukim, për këtë lloj komunikimi.</p>
21	<p>Artet e bukura</p> <p>Në këtë kurs do të shfrytëzohen njohuritë për historinë e artit, për punën në grupe, punën praktike dekorative me letra, formësim gjësendesh nga kartoni ose letra. Mjetet e punës për kreativitet figurativ dhe përdorimi praktik i tyre. Teknikat e artit figurativ me aplikacion. Përdorimi i shablloneve, kopjimi, prerja dhe ngjitja. Vizatimi simetrik me ndihmën e palosjes. Pikturimi akuarel, kolazhi, mozaiku, metodat dhe avantazhet e aplikimit të tij. Pikturimi, llojet e materialeve dhe përdorimi i tyre. Formësimi me plastelinë e brumë, mjetet e duhura për përdorim. Vizitë në galeri artesh. Ekspozita me punimet më të mira të nxënësve. Ndërtimi i planditarit dhe plankonspektit.</p>
22	<p>Partneriteti i IP me komunitetin</p> <p>Kursi do t’u ofrojë mundësi studentëve për të kuptuar rëndësinë e partneritetit të institucionit parashkollor me komunitetin.</p> <p>Do të trajtohen përmbajtje, prej të cilave do të analizohet ndikimi që komuniteti mund të ketë në zhvillimin e procesit të edukimit të fëmijëve parashkollorë. Studentët do të kenë mundësi që të njihen me qasje të ndryshme, të cilat e zhvillojnë bashkëpunimin efektiv me komunitetin, në mënyrë që të përfshijë edhe aktorë të tjerë që mund të ndihmojnë në ngritjen e cilësisë së punës edukative të institucioneve parashkollore. Bashkëpunimi me komunitetin gjithashtu do të trajtohet edhe si plotësim i aktiviteteve të planifikuara nga edukatorët, të cilat mund të plotësohen me vizita në vende dhe institucione të ndryshme, që do t’i ndihmojnë ata të njihen për së afërmi me funksionin</p>

	e tyre.
23	<p>Gjithëpërfshirja në edukimin parashkollor</p> <p>Kursi do trajtojë çështje si: njohuritë mbi nocionet dhe bazat e gjithëpërfshirjes në edukimin parashkollor; vëzhgimi, identifikimi dhe vlerësimi i foshnjave dhe i fëmijëve me nevoja të veçanta; intervenimi i hershëm, shërbimet e hershme dhe plani individual i arsimit (PIA), edukimi gjithëpërfshirës i fëmijëve me: retardim mental, sindromën e Down-it, autizëm, dëmtime në të dëgjuar dhe të parë, invaliditetet trupor, çrregullime të të folurit, gjuhës dhe zërit, disleksi, disgrafi dhe diskalkuli, si dhe i fëmijëve të talentuar.</p>
24	<p>TIK në edukimin parashkollor</p> <p>Temat e trajtuara në kurs do të jenë: gjeneratat e kompjuterëve, sistemi kompjuterik, sistemet operative, Windows, programet aplikative, informacionet dhe komunikimet. softuerët arsimorë për fëmijë.</p> <p>Qëllimet e mësimi: njohja e studentëve me historikun e shkurtër të gjeneratës së kompjuterëve, njohja me njësitë themelore të kompjuterit, sistemin operativ Windows, programin aplikativ Word, programin aplikativ PowerPoint dhe puna me Internet. Aftësimi për të shfrytëzuar programet aplikative në aktivitete me fëmijë. Lojërat arsimore me kompjuter.</p>
25	<p>Konceptet gjeometrike në fëmijërinë e hershme</p> <p>Në këtë kurs do të shqyrtohen teoritë për zhvillimin e të menduarit për hapësirën dhe kuptimet gjeometrike në fëmijërinë e hershme. Gjatë kursit, studentët do të shqyrtojnë konceptet themelore gjeometrike, si: figurat gjeometrike, madhësitë dhe raportet e tyre, pozitat në hapësirë, lëvizjet dhe orientimin, dhe do të aftësohen për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përshtatshme me fëmijët 3-6 vjeç.</p> <p>Qëllimi parësor i kursit është njohja e studentëve me vetitë dhe dinamikën e hapësirës, formave gjeometrike, madhësive dhe raporteve, në mënyrë që ata/ato të aftësohen për planifikime të aktiviteteve praktike me fëmijët 3-6 vjeç. Po ashtu, studentët do të përgatiten për shqyrtim dhe analizë kritike të ndikimit të aktiviteteve me objekte të formave gjeometrike dhe zhvendosjen e tyre në hapësirë dhe si të japin kontributin e tyre në zhvillimin intelektual dhe fizik të fëmijës</p>
26	<p>Praktikë pedagogjike II (5 javë)</p> <p>Gjate kursit do të fokusohen çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe të kuptuarit e praktikave arsimor në kuadër të institucioneve parashkollore. Fillimisht gjatë ligjëratave do të shqyrtohen qasjet teorike të edukimit në fëmijërinë e hershme, me theksim të veçantë në njohjen me trendet bashkëkohore të edukimit parafillor. Në praktikën mësimore, studentët do të zhvillojnë shkathtësitë e vëzhgimit, do të njohin</p>

	<p>elementet bazë të programit me fëmijën në qendër, planifikimin e punës edukative të suksesshme në këtë nivel arsimor, do kuptojnë elementet e komunikimit të efektshëm ndërpersonal, si dhe krijimin e një klime të shëndoshë socio-emocionale në mjedisin e kopshtit.</p>
27	<p>Zhvillimi socio-emocional</p> <p>Në përgjithësi kursi tenton të qartësojë nocionet e ndjenjave dhe reagimet afektive të fëmijës në periudhën e fëmijërisë së hershme, dhe reaksionet e ndërveprimet e para sociale të fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku ai jeton; si dhe ndikimin e këtyre të fundit në zhvillimin psiko-social të tij. Kursi synon në aftësimin e studentëve për të kuptuar më mirë zhvillimin e fëmijës në aspektin emocional dhe social, mënyrat e tij të reagimit, si fëmija i shfaq emocionet, si zhvillohen ato, si socializohet fëmija, sa është e rëndësishme njohja e emocioneve dhe aspekteve sociale të zhvillimit të fëmijës që nga foshnjëria e tutje, dhe si të kujdesemi për fëmijën që mos të krijojme vështirësi emocionale dhe sociale në zhvillimin e tyre.</p>
28	<p>Kulturë e të folurit</p> <p>Përmes këtij kursi studentët do t'i thellojnë njohuritë e tyre përkitazi me: parimet e drejtshkrimit të shqipes; strukturën e rregullave të drejtshkrimit të shqipes; drejtshkrimin e zanoreve të theksuara e të patheksuara në fjalë; grupet e zanoreve e të diftongjeve; për takimin dhe përdorimin e dy zanoreve të njëjta; apostrofin; theksin; drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve; bashkëtingëlloret e zëshme në trup dhe në fund të fjalës; shkrimi i bashkëtingëllores H; fjalët me rr; nj-ja në trup dhe në fund të fjalës; takimi i bashkëtingëlloreve; takimi i dy bashkëtingëlloreve në fjalë.</p>
29	<p>Këndimi koral- KORI</p> <p>Kursi është i ndarë në disa pjesë: pjesa e parë përfshinë ndarjen e koristëve-studentëve në zërat përkatës për këndim. Pastaj ushtrimet për këndimin melodik duke filluar nga tingujt, intervalet e pastaj kuintakordet me rrotullime. Ushtrimi i vokalizave për formësimin e zërave dhe krijimin e përvojës bazike për këndim koral. Duke vazhduar me këndimin e këngëve të ndryshme nga kompozitorë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj .Qëllimi i kursit është që studentin ta aftësojë për këndim në ansambël koral duke zhvilluar aftësitë dhe shkathtësitë për: punë-këndim grupor, pastërti intonative dhe ritmike, dëgjim harmonik, përcjellje aktive dhe realizim në të kënduar të mjeteve teknike. Këndim sipas metodave të ndryshme varësisht nga predispozitat muzikore si: këndimi sipas imitimit, këndimi në mënyrë të vetëdij shme-pavarur dhe këndimi sipas metodës globale.</p>
30	<p>Eksperimenti në fëmijërinë e hershme</p> <p>Ky kurs ka për qëllim të sigurojë studentët edukatorë të ardhshëm me përvojë praktike</p>

	<p>në demonstrime eksperimentale dhe strategji të mësimdhënies. Kursi ofron një qasje interaktive të temave të integruara të shkencës nëpërmjet qasjes së studentit drejtpërdrejtë në eksperimente dhe teknologji të lehta për t'i vepruar. Eksperimentet e këtij kursi dhe aktivitetet e mësimdhënies që studenti do t'i përvetësojë në këtë kurs, do t'i ndihmojnë ata që të sfidojnë dhe të motivojnë nxënësit dhe në të njëjtën kohë do t'i japin nxënësit mundësinë për të fituar aftësitë shkencore të të nxënit të drejtpërdrejtë. Qëllimi i kursit është që studentët jo vetëm të mësojnë shkencën, por edhe të gëzojnë atë në të njëjtën kohë me fëmijët në çerdhe apo shkollë, që të zhvillojnë aftësitë efektive dhe mundësi tjera për të komunikuar shkencën për audiencë të ndryshme dhe në mënyrë të veçantë për fëmijët në nivelin parashkollor.</p>
31	<p>Organizimi dhe menaxhimi në kontekst të edukimit</p> <p>Ky është kurs themelor i fushës së menaxhimit dhe udhëheqjes në arsim, duke synuar që studentët të kuptojnë nocionet themelore të fushës së menaxhimit dhe udhëheqjes si dhe të kuptojnë sistemin arsimor të Kosovës. Kursi gjithashtu synon që të ndihmojë studentët, që të kuptojnë aspektet kryesore të menaxhimit të një institucioni arsimor me fokus të veçantë. Kursi përmban njohuri mbi format e organizimit dhe menaxhimit të mirë të ambienteve në institucionet parashkollore, përmes rregullimit adekuat të ambientit fizik edukativ si dhe përmes përcaktimit të orareve e rutinave ditore, të cilat influencojnë zhvillimin emocional, kognitiv, gjuhësor, fizik dhe social të fëmijëve parashkollorë.</p>
32	<p>Zhvillimi motorik me metodologji</p> <p>Kursi përmban njohuri për konceptet dhe nocionet bazë të edukimit fizik dhe karakteristikave të tij për grupmoshën parashkollore. Përmbajtja fokusohet në mënyrën e zhvillimit të aftësive lëvizore bazike, aftësive fine, aftësive manipulative dhe sporteve për këto grupmosha. Fokusi vendoset në prezantimin e ligjshmërive për zhvillimin dhe të mësuarit e shkathtësive motorike si dhe prezanton një mori të metodave dhe mënyrave të përshtatshme për grupmoshat parashkollore.</p>
33	<p>Vështirësitë në të nxënë</p> <p>Njohuritë mbi nocionet dhe bazat e vështirësive në të nxënë. Llojet e vështirësive në të nxënë – modelet e klasifikimeve. Definicionet dhe karakteristikat e vështirësive në të nxënë. Terminologjia, definicionet, aspektet edukativo-arsimore të disleksisë, disgrafisë dhe diskalkulisë. Vështirësitë në të nxënë si pasojë e çrregullimeve në të folur dhe gjuhë, dëmtimeve në të dëgjuar, në të parë, prapambetjes intelektuale, çrregullimeve në sjellje, si dhe pranisë së njëkohshme të llojeve të ndryshme të vështirësive në të nxënë.</p>
34	<p>Komunikimi në arsim</p>

	<p>Në këtë kurs do të shqyrtohet fillimisht roli dhe rëndësia e komunikimit efektiv në mjedise edukative. Gjithashtu do të shqyrtohen nocionet themelore të komunikologjisë, teoritë e komunikimit, funksionimi i komunikimit ndërpersonal në fëmijërinë e hershme, që kanë peshë të veçantë për të trajtuar drejtë problemin. Komunikimi në mes të subjekteve në mjediset edukative, komunikimi si proces i marrjes dhe dhënies së informatave, llojet e komunikimit, shkathtësitë e komunikimit ndërpersonal, klima socio-emocionale për komunikim të efektshëm ndërpersonal, komunikimi edukator-prind, zhvillimi i komunikimit verbal dhe roli i edukatores në këtë proces domosdoshmërisht do të arsyetojnë kuptimin e qenësisë së kursit në fjalë.</p>
35	<p>Gjuhë angleze I</p> <p>Përvetësimi dhe zgjerimi i njohurive elementare nga lënda e gjuhës angleze; të shtjelluarit e shkathtësive elementare: të folurit, shkrimin dhe leximin në gjuhën angleze, komunikimi me gojë dhe me shkrim, leximi dhe përvetësimi praktik i gramatikës për këtë nivel do të jenë trajtimet bazë të këtij kursi.</p>
36	<p>Biologjia për edukatorë</p> <p>Kursi ju dedikohet studentëve që përgatiten për edukatorë, për t'i njohur me jetën e gjallë në përgjithësi, karakteristikat, organizimin dhe funksionimin e saj në të vetmin planet ku ajo dihet se ekziston deri sot. Kursi trajton njohuritë shkencore nga aspektet e jetës së gjallë, qelizës, indeve, organeve, fiziologjike, ekologjike, gjenetike dhe evolutive të qenieve të gjalla të përcjella edhe me komponentin metodologjik dhe didaktik. Qëllimet kryesore të kursit janë: njohja me jetën dhe organizimin e saj, klasifikimi i organizmave në mbretëritë kryesore të botës së gjallë, kompleksiteti i funksionimit të jetës së gjallë, riprodhimi dhe zhvillimi të bimët, shtazët dhe njeriu, evolucioni i formave të jetës së gjallë dhe ngjarjet kryesore në evolucion, marrëdhëniet e organizmave të gjallë me mjedisin e jashtëm.</p>
37	<p>Lojërat ritmike dhe vallëzimi</p> <p>Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktike të përgatiten për të njohur dhe përzgjedhur lojërat ritmike dhe elementet e vallëzimit, si dhe për mënyrat, format, teknikat e implementimit të tyre në ambientet institucionale. Përveç kësaj, ata do të njohin mënyrat e përshtatjes së përmbajtjes me karakteristikat e secilit fëmijë, duke pasur parasysh individualitetin dhe inteligjencat e shumëfishta. Përmbajtja ka karakteristikë ndërthurjen e ngushtë të argëtimit dhe të të nxënit në fëmijërinë e hershme.</p>
38	<p>Psikologji kognitive</p> <p>Kursi mundëson që studentët të përvetësojnë konceptet, përmbajtjet dhe teoritë bazë që lidhen me njohjen dhe zhvillimin e njohjes (kognicionit) tek fëmijët që nga moshë e</p>

	<p>hershme, menjëherë pas lindjes. Do të kenë mundësinë e njohjes me perspektivat në fushën e psikologjisë kognitive dhe zhvillimit të fëmijëve në vend dhe më gjerë dhe të kuptojnë psikologjinë kognitive si studimi i rrugëve dhe përpjekjeve për zhvillimin e të menduarit në përgjithësi.</p>
39	<p>Strategjitë e edukimit parashkollor</p> <p>Në këtë kurs përfshihen konceptet themelore të strategjive të edukimit bashkëkohor, përkatësisht njohja me strategjitë alternative të edukimit parashkollor. Mbështetjen e tyre në teoritë e të nxënimit me “fëmijën në qendër”. Të informohen lidhur me strategjitë bashkëkohore të edukimit parashkollor dhe studimin e përparësive të tyre, në kontekst të mjedisit jetësor të fëmijës. Të reflektojnë për përparësitë e strategjive të ndryshme edukative duke i ndërlidhur ato me teoritë bashkëkohore e të nxënimit parashkollor. Të praktikojnë forma të ndryshme të organizimit të aktiviteteve me fëmijët parashkollor, duke i ndihmuar ata të arrijnë të zhvillojnë kompetencat e parapara për secilën fushë të KKK.</p>
40	<p>Lojërat matematikore</p> <p>Përmes këtij kursi studentët do të njihen me rolin dhe rëndësinë e lojërave matematikore për nivelin e edukimit parashkollor; rezultatet e hulumtimeve bashkëkohore në të kuptuarit e matematikës me anë të lojërave matematikore; Do të shqyrtohet klasifikimi i lojërave matematikore; formimi i koncepteve matematikore me anë të lojërave matematikore, teknologjia e lojërave matematikore si dhe metodat kryesore të mendimit dhe hulumtimit në matematikën parashkollorë si dhe zbatimi i tyre në realizimin e aktiviteteve matematikore.</p>
41	<p>Psikologji e edukimit</p> <p>Psikologjia e edukimit synon të japë njohuri për zhvillimin, të nxënimit dhe mësimdhënien. Kursi do të trajtojë çështje mbi edukimin e fëmijëve që nga lindja deri në moshat e rritura, zbatimin e psikologjisë në studimin e zhvillimit, të nxënimit, mësimdhënies, motivimit dhe çështjeve tjera, që ndërlidhen me procesin e edukimit si dhe aplikimin praktik të parimeve psikologjike të mësimdhënies.</p>
42	<p>Letërsi për fëmijë</p> <p>Ky kurs, në përmbajtje të tij përfshin elemente të strukturës letrare në letërsinë për fëmijë siç janë: proza, poezia, drama dhe rrymat e tjera bashkëkohore. Gjithashtu ofrohen edhe metoda të analizave dhe interpretimeve të veprave të njohura të letërsisë për fëmijë, shqipe dhe botërore. Ofrohen edhe teknika të leximit, të cilat nxisin imagjinatën dhe zhvillojnë të menduarit kritik e kreativ tek fëmijët parashkollorë.</p>

43	<p>Dramatizimi, dhe shfaqjet me kukulla</p> <p>Dramatizimi i një teksti qoftë ai roman apo tregim. Teksti dramatik i shkurtuar dhe i dramaturgjuar për teatër. Zanafilla e teatrit të kukullave. Zhvillimi i këtij teatri. Loja e aktorit me kukullën. Pantomima. Teatri i hijeve dhe zanafilla e këtij teatri. Lëvizjet skenike, teknika e zërit, luftërat skenike dhe diksioni. Raporti i aktorit me tekstin. Muzika, kostumografia, skenografia, ndriçimi në teatrin e kukullave. Studentët përmes këtij kursi do të fitojnë njohuri të reja dhe aftësi për të punuar me gjeneratat e reja në entet parashkollore, duke i përdorur të gjitha kërkesat didaktiko-pedagogjike të kulturës së përgjithshme të dramatizimit dhe shfaqjeve të kukullave, të cilat në entin parashkollor zënë vend si aktivitete të rëndësishme.</p>
44	<p>Praktikë pedagogjike III (6 javë)</p> <p>Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: specifikat e planifikimit të punës edukative në fëmijërinë e hershme, planifikimi i kurrikulumeve të ndërlydhura, vlerësimi në fëmijërinë e hershme, përgatitja e mjeteve mësimore, duke përdorur materialet ricikluese dhe materiale tjera, të cilat janë në dispozicion.</p>
45	<p>Politikat arsimore dhe dokumentacioni pedagogjik</p> <p>Ky kurs theksin e vë në lidhshmërinë e ngushtë të procesit edukativo/arsimor me politikat për edukimin e hershëm. Përmbajtja fokusohet në infrastrukturën ligjore dhe atë profesionale, në implementimin e tyre në kontekstin institucional. Të kuptuarit e rëndësisë së implementimit të legjislacionit në realizimin e punës me fëmijët. Plotësimin e dokumentacionit pedagogjik në procesin e edukimit, të mbështetur në legjislacionin në fuqi, zhvillimin i shkathtësive për të plotësuar dhe reflektuar në zbatimin e dokumentacionit ligjor dhe profesional në punën edukative. Studentët do të kenë mundësi që të integrojnë kërkimet shkencore me implementim të politikave, shfrytëzimin e njohurive dhe reflektim në praktikën me fëmijë</p>
46	<p>Gjuhë angleze II</p> <p>Përvetësimi dhe zgjerimi i njohurive elementare nga lënda e gjuhës angleze; të shtjelluarit e shkathtësive elementare: të folurit, shkrimi dhe leximi në gjuhën angleze. Komunikimi me gojë dhe me shkrim, leximi dhe përvetësimi praktik i gramatikës për këtë nivel.</p>
47	<p>Zhvillimi profesional i mësimdhënësve</p> <p>Kursi ka si bazë të kuptuarit e konceptit, qëllimit dhe nevojës së zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Kursi ofron një përmbledhje të formave të ndryshme të zhvillimit profesional si dhe përparësitë dhe mangësitë e secilit model. Studentët do të trajtojnë karakteristikat e zhvillimit profesional efektiv dhe do të mësojnë format e bashkëpunimit kolegial në shkollë si formë e zhvillimit profesional.</p>

48	<p>Çrregullimet në sjellje</p> <p>Përkitazi më kurset tjera të psikologjisë si ajo zhvillimore, e edukimit dhe kognitive, në këtë kurs pretendohet të thellohen dhe të shtrihen me tutje njohuritë lidhur me sjelljen dhe me çrregullimet e saj, për t'i aftësuar studentët t'i zbatojnë ato njohuri në ndërveprimin që kanë me fëmijët. Kursi ka një karakter teoriko-praktik, përmes së cilës edukatorët e ardhshëm të përfitojnë njohuritë, kompetencat dhe qëndrimet e nevojshme për të identifikuar dhe menaxhuar çrregullimet e sjelljes, që mund të lindin gjatë periudhës së parë të shkollimit. Studenti do të përgatitet të identifikojë, vlerësojë dhe ndërhyjë në çështjet e lidhura me sjellje të çrregullta, të cilat mund të prezantohen në nivel klase.</p>
49	<p>Etika profesionale</p> <p>Kursi udhëzon njohjen dhe respektimin e parimeve morale si nevojë të domosdoshme për çdo profesion e aq më tepër për profesionin e mësimdhënësit. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të profilit të punonjësit arsimor, duke filluar nga fillet e para të organizimit spontan të transmissioinit të diturive, shprehive dhe shkathtësive në kontekstin gjenerativ e deri te profili i punonjësit në shoqërinë bashkëkohore.</p> <p>Në kurs trajtohet të drejtat dhe obligimet morale, që duhet t'i posedojë mësimdhënësi për të realizuar raportet ndërnjerëzore në veprimtarinë arsimore. Kursi promovon tri aktivitetet kryesore të veprimtarisë arsimore të punonjësit arsimor, duke filluar nga dituritë, vendimmarrja dhe sjellja, si shkathtësi të pashmangshme, të cilat e karakterizojnë personalitetin e mësimdhënësit.</p>
50	<p>Vlerësimi në edukimin e hershëm</p> <p>Gjate kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: rëndësia e vlerësimit në fëmijërinë e hershme, qasjet teorike rreth vlerësimit në fëmijërinë e hershme, njohja dhe zotërimi i aftësive për zbatimin e teknikave formale për vlerësim siç janë: dosja e punës së fëmijëve, performanca e tyre, lista e kontrollit, regjistrime të ndryshme të sjelljes përmes magnetofonit, kamerave, fotove etj., vizatimet e fëmijëve, etj. si dhe planifikimi i procedurës të vlerësimit. Peshë të veçantë në vlerësim ka dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura përmes këtyre teknikave.</p>
51	<p>Metodologji e shkencave natyrore</p> <p>Kursi përmban njohuri themelore nga: astronomia, fizika, kimia dhe biologjia. Në këtë kurs studentët fitojnë dituri të reja për shkencat natyrore dhe lidhjet e tyre me njër-tjetrën. Nëpërmes kursit <i>Metodologji e shkencave natyrore</i>, studentët do të njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e ligjeve të natyrës. Në këtë</p>

mënyrë ata formojnë qëndrim të drejtë ndaj ruajtjes së mjedisit jetësor, kursimit të energjisë si dhe fitojnë shkathtësi jetësore e shprehje të punës. Fizika si shkencë e natyrës së bashku me shkencat tjera ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit të njeriut, në ngritjen e tij kulturore dhe profesionale.

52 Punë dore me modelim

Punimet prej letrës: gota, varka, topi, aeroplani, kapela, mjellma, babadimri, fluturakja, mbajtësi i qiriut, pjata, miu, mollëkuqja, qesja e vogël, qesja e madhe, lule prej letre dhe dy punime sipas dëshirës, prej letrës. Punimi i dy modeleve në copë guri natyror. Seminari nga punimet e punuara. Punimi i pemëve dhe perimeve prej plastelinës, lule prej plastelinës dhe gjësende të tjera. Teknologjia e materialit ndërtimor; punimi i gjerdanit dhe byzylyku prej argjile. Seminar nga punimet e punuara prej materialit ndërtimor dhe plastelinës. Rregullat e mirësjelljes në shtëpi, shkollë, autobus, rrugë, lokal, etj. Punimi praktik nga lëmi i pastërtisë. Punimi praktik i futrollës për syze, lapsit prej lëkure me dimensione të caktuara si dhe vizatimi në letër në format A4. Punimi seminarik nga lëmi i materialit për tekstil dhe llojet e tekstilit. Punimi seminarik dhe në mënyrë praktike- ora me akrepa prej kartuçi. Punim praktik për ditët e javës dhe muajt e vitit. Punim seminarik për vitin, muajin, javën, ditët dhe ndërrimin e motit. Punimi i instrumentit muzikor prej stiropori ose fjolla bore, semafor ose shkronja. Punimi seminarik me punime praktike mbi rrezikun që i kanoset njeriut gjatë jetës në pakujdesinë e tij. Formimi i figurës dhe trupit gjeometrik prej pjesëve të prera.

53 Edukimi mjedisor

Çdo gjë që bëjmë ka një ndikim në botën rreth nesh - nga rrobat që ne veshim dhe ushqimi që hamë, deri te kopshtet që i kultivojmë dhe mbeturinat që i hedhim. Dhe për t'u kujdesur më të mirë për tokën dhe veten - është e rëndësishme të bëjmë zgjedhje të zgjuara. Kursi, *Edukimi mjedisor*, është projektuar për të ndihmuar studentet për të gjetur se çfarë mund të bëjnë ata çdo ditë që të ndikojnë në mbrojtjen e planetit tonë dhe ndihmon në përgatitjen e tyre për të zbatuar mundësitë e edukimit mjedisor në mjedise formale dhe jo - formale të arsimit, nëpërmjet edukimit të hershëm. Gjatë këtij kursi studenti do të jetë i ekspozuar ndaj çështjeve mjedisore dhe vendimmarrjes, në botën e vërtetë të jetës, në të cilën ata jetojnë. Përmes, të nxënimit për mjedisin, të nxënimit përmes mjedisit, kursi do të nxisë veprime pozitive mjedisore, për të lehtësuar lëvizjen drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

54 Puna me projekte edukative

Përmes këtij kursi studentët do të njihen me rëndësinë e punës me projekte dhe ndikimin e kësaj strategjie në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve parashkollorë. Do të kenë mundësi të analizojnë forma të ndryshme të punës me projekte dhe të reflektojnë

	<p>për të arriturat e zhvillimit njohës, fizik, social, emocional të fëmijëve përmes projekteve. Do të aftësohen se si të planifikojnë dhe organizojnë punë bazuar në projekte me fëmijët parashkollorë si dhe të inkorporojnë qasjen e metodologjive bashkëkohore, të cilat e mbështesin edukimin e fëmijëve përmes realizimit të projekteve të vogla.</p>
55	<p>Shkathhtësitë e gatishmërisë për shkollë</p> <p>Ky kurs në përmbajtje të tij ofron njohuri mbi definimin e gatishmërisë për shkollë, objektivat kryesore të gatishmërisë për shkollë siç janë: zhvillimi social dhe emocional i fëmijëve, zhvillimi i shkathhtësive, aftësive e karakteristikave, të cilat promovojnë mundësitë që të jenë nxënës të mirë, familjarizimi me ambientin shkollor, ndërgjegjësimi mbi rregullat shkollore, rutina dhe kërkesat që ka shkolla. Më pas ofrohen edhe indikatorët e gatishmërisë për shkollë, aftësitë e përshtatshme që duhen poseduar nga çdo fëmijë para se të fillojë klasën e parë etj. Përfshirja e familjes dhe institucionit shkollor si pjesë e gatishmërisë për shkollë, po ashtu zë vend të rëndësishëm në këtë lëndë.</p>
56	<p>Metodologji e leximit letrar</p> <p>Kursi <i>Metodologji e leximit letrar</i> përkufizon modelet e leximit të vëmendshëm dhe të kuptueshëm të krijimtarisë letrare-artistike me qëllim që të nxirret struktura e teksteve letrare, që krijohen dhe perceptohen nga grup-moshat e fëmijëve parashkollorë. Ky kurs përmban shumë faktorë dhe mënyra të shprehjes letrare në një tekst, që na detyrojnë të bëjmë kujdes në përcaktimin sa më të saktë të domethënies së tij, zbulimit të natyrës së fjalëve, interpretimit të tyre, kapjes së synimit të autorit, vokacionit, ritmit të prozës, vargut, strofës. Në programin parashkollor, si tekste bazë për lexim do të jenë krijimtaria popullore (përralla, përrallëza, fabula, ninullat, gjëzat, këngët dhe lojërat popullore) dhe ajo e shkruar për këtë grup-moshë të fëmijëve.</p>
57	<p>Metodologji e hulumtimit në edukimin parashkollor</p> <p>Do të shqyrtohen çështje të tilla si: qasjet teorike të metodologjisë së hulumtimit në çështjet e arsimit në përgjithësi, zotërimi i aftësive për zbatimin e metodave hulumtuese dhe të nxënës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë, për përgatitjen e punimeve të ndryshme e sidomos të punimit të diplomës, diskutime të të nxënës në bashkëpunim me të tjerët, komunikimi dhe prezantimi i rezultateve të hulumtimit.</p>
58	<p>Praktikë pedagogjike IV (8 javë)</p> <p>Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: planifikimi i punës edukative sipas karakteristikave të moshës në fëmijërinë e hershme, si dhe veçantive të programit me të cilin punohet. Do të punohet më konkretisht në plane individuale për zhvillimin e</p>

fëmijëve në varshmëri me nevojat, potencialin zhvillimor të tyre, por edhe në vlerësimin e zhvillimit të fëmijëve në dimensione të ndryshme, do të diskutohet përgatitja e mjeteve mësimore, strategjitë interaktive për grupe të vogla, bashkëpunimi me stafin profesional në institucionin parashkollor, me familjen dhe komunitetin. Ndërkohë, studentët vetëvlerësojnë ngritjen e tyre profesionale.

59

Tema e diplomës

Punohet në bashkëpunim me profesorin mentor sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit për studime Bachelor.